



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR

Nr. 148 Prot

Shkodër, më 07.01.2020

VENDIM

Nr. 04 Datë 07.01.2019

**‘PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE’**

Në mbështetje të neneve 8, 9 të ligjit nr. 139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ i ndryshuar; nenet 28,29 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 ‘Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë’; ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ‘ të ndryshuar; udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 ‘Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit’ të ndryshuar, udhezimit nr.30, datë 27.12.2011 ‘Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik’ të ndryshuar

**VENDOSA:**

- I. Delegimin e kompetencave zv/kryetarit, zj.Emilja Koliqi, per firmosje të cdo korrespondece shkresore që i drejtohet kryetares së Bashkisë Shkodër.
- II. Delegimin e kompetencave zv/kryetarit, zj.Emilja Koliqi , per firmosje te konfirmimeve te shpalljeve qe behen ne bashkine Shkoder, per llogari te gjithë institucioneve.
- III. Delegimin e kompetencave zv/kryetarit, zj.Emilja Koliqi, per firmosje të autorizimeve per perfaqesim ligjor prane gjykatave kompetente, të kerkese padive, deklaratave te mbrojtjes, bisedimeve perfundimtare, ankimeve, kerkesave, prane gjykatave kompetente , ne te cilat Bashkia Shkoder eshte pale ne procese gjyqsore.
- IV. Delegimin e kompetencave zv/kryetarit, zj.Emilja Koliqi, per firmosje të urdher dorezimeve per furnizim me baze materiale, karburant, gaz per te gjithë drejtorite.
- V. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen për periudhen nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, deri ne datë 31.12.2020.
- VI. Zv.Kryetari nuk mund t’i nëndelegojë keto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi menjehere dhe publikohet ne faqen web të Bashkisë Shkodër.



**KRYETAR**  
Voltana Ademi